

GAZETA REPUBLIKA E BOSTONIT, PARAROJË E PËRKTHIMIT TË
DON KISHOTIT NGA NOLI

Dr. Admira Nushi

Departamento de Lengua y Literatura Española
Facultad de Lenguas Extranjeras, Universidad de Tirana
E-mail: admira.nushi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Fan Noli shqipëroi kryeveprën e Cervantes-it *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës* dhe e botoi në gazetën shqiptare të përjavshme në Amerikë, *Republika*. Kjo gazetë e cila trajtoi temën e Shqipërisë e të shqiptarëve, me preokupimin kryesor përparimin e vendit, botoi shkrime kritike mbi librin si dhe artikujt e Nolit mbi eksperiencën e tij përkthimore. Botimi i librit pati jehonë në disa revista në Amerikë dhe u konsiderua emancipim i lexuesit shqiptar, sukses i gjuhës shqipe, gjenialitet i përkthyesit. Ne i kemi dhënë vend e rëndësi komenteve të Nolit mbi eksperiencën e tij përkthimore, sepse na tërheqin drejt botës së përkthyesit dhe analizave, vendime që ai mori gjatë procesit të përkthimit, duke i vlerësuar këta artikujt si origjinalë me vlerën e patjetërsueshme të dokumentit. Rëndësi në këtë artikull kanë marrë edhe emrat e komentet e personaliteteve shqiptare të kohës, të cilët të përfshirë në debatin kulturor disa herë me ngjyrime politike, vijnë më së shumti me pseudonimet e tyre. Ata na zbulojnë panoramën kulturore, ideologjike e politike të kohës duke na përcjellë dhe ndërthurjen e këtyre panoramave.

Fjalët çelës: debat, gazetë përparimtare, kulturë, shkrime kritike, roman i përkthyer.

ABSTRACT

Fan Noli translated Cervantes's masterpiece *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës* and published it in the Albanian weekly newspaper in America, *Republika*. This newspaper, which addressed the topic of Albania and the albanians, with the main concern of the country's development, published critical writings on the book as well as Noli's articles on his translation experience. The publication of the book was echoed in several magazines in America and was considered an emancipation of the Albanian reader, success of the Albanian language, genius of the translator. We have given place and importance to Noli's comments on his translation experience, because they draw us into the world of the translator and the analysis and decisions, he made during the translation process, valuing these articles as originals with the invaluable value of the document. The names and comments of the Albanian personalities of the time have also taken importance in this article, who were involved in the cultural debate and several times with political nuances, come mostly with their pseudonyms. They reveal to us the cultural, ideological and political panorama of the time, transmitting to us the intertwining of these panoramas.

Keywords: critical writing, culture, debate, progressive newspaper, translated novel.

Hyrje

Diplomati, shtetari, prifti, shkrimtari, muzikologu e përkthyesi Fan Noli shqipëroi vëllimin e parë të kryeveprës së Cervantes-it, titulluar në shqip *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës*, në vitet 1932- 1933, në pesë vëllime dhe e botoi në gazetën shqiptare të përjavshme në Amerikë, *Republika*. Kjo gazetë cila u themelua nga Noli ndërsa u rikthye në Boston nga Europa, botoi shkrime me karakter shoqëror, politik, letrar, trajtoi temën e Shqipërisë e të shqiptarëve me preokupimin e rëndësishëm, përparimin e vendit. Ndër të tjera, themeluesi i gazetës dhe përkthyesi i librit botoi shkrime kritike mbi librin si dhe shënimet e tij mbi eksperiencën përkthimore.

Noli me një pasion të jashtëzakonshëm i jepet përkthimit të librit pas betejave të rëndësishme politike në parlamentin shqiptar dhe si udhëheqës shteti. Ai udhëhoqi Revolucionin Demokratik të Qershorit të vitit 1924, dështoi e më pas i ligështuar e i zemëruar mori rrugën e mërgimit. Si intelektual iu përkushtua përkthimit të klasikëve botërorë dhe mund të krahasohet me mjeshtrit më të mëdhenj të përkthimit.

Kadare mendon se veprat që Noli përzgjodhi për përkthim kanë lidhje të drejtpërdrejte me aktivitetin politik e shoqëror të tij dhe u vunë në shërbim të tij.

Don Kishoti u përkthye në shqip nga peshkopi i Shqipërisë. Ky peshkop ishte në luftë me mbretin e ardhshëm të Shqipërisë. Peshkopi përpiqej ta përmbyste monarkun. Për t'u dhënë guxim njerëzve e në radhë të parë vetes, në fillim përktheu Hamletin dhe Makbethin dhe arriti vërtet ta përmbyste mbretin. Më pas, mbreti e rrëzoi përsëri peshkopin dhe u përmbys situata dhe, ndërsa peshkopi ishte i ngujuar tejet i trishtuar, iu vu përkthimit të Don Kishotit. (Kadare 46)

Botimi i parë, i plotë librit të përkthyer shqip, *Sojliu mendje – mprehtë Don Kishoti i Mançës*, u realizua në Boston, nga Shtëpia Botuese Mass, në vitin 1933. Vepra u shoqërua me introduktën e shkruar nga vetë Noli, e cila zevëndëson prologun e shkruar nga Cervantes-i. Punën e tij për të sjellë *Kishotin* në shqip e filloi aty nga viti 1930, pasi kishte shqipëruar më parë disa kryevepra të letërsisë botërore si *Otello*, *Jul Qezari*, *Makbethi*, *Hamleti* të Shekspirit, *Kasollja* e Vicente Ibañez, *Armiku i Popullit*, *Zonja Ingra* e Ostrotit të Ibsen, *e Rubairat* e Omar Khajam.

1. Noli krijues i shkollës së re të përkthimit

Noli e prezantoi *Don Kishotin* në gazetën *Republika* me dëshirën e mirë që lexuesi shqiptar ta merrte në duar sa më parë, ndërsa rriti dhe numrin e abonimeve në gazetë nxiti lexuesin ta blejë e ta lexojë librin numër pas numri, me premtimin që nuk do zhgënjehen por do ta pëlqejnë e do ta njohin si të ishte shqiptar.

Për ta mbaruar (së lexuari) duhet thënë me të drejtë se vetëm faqja e katërt e “Republikës”, ku botohet Don Kishoti i shqipëruar, vlen pajtimi, që kërkojmë për gazetën tonë... mos u kurseni, po na dërgoni pajtimet.... Jua kërkojmë jo vetëm ne, po jua kërkon dhe i dëgjuari kalorës i arratisur, Don Kishoti i Mançës, që po jua paraqitim me takie e fustanellë. Në mos ia mbarofshi dëshirën, atëherë nuk do ta këndonin dot historinë e tij shqip, në gjuhën e vendit që i përshtatet sot më tepër se çdo tjetër nga anakronizma. (Noli, 1931:1)

Noli shkroi se ai e ka realizuar një shqipërim të veprës, ndërsa e ndërthuri organikisht elementë të kulturës e gjuhës shqipe “takie e fustanellë”, “anakronizma”. Vëmë re se kritika shqiptare e të gjitha kohërave e ka mbështetur këtë pretendim, pra bëhet fjalë për një shqipërim dhe jo përkthim të saj. Duhet theksuar se fjalori zyrtar i gjuhës shqipe nuk njeh dallime kuptimore mes përkthimit dhe shqipërimit por kritika letrare duke filluar nga Noli vetë, me termin shqipërim nënkupton një përkthim krijues, jo besnik ndaj tekstit origjinal, rikrijim. Studiuesi Aurel Plasari pranon se Noli ka një metodë të tijën përkthimore, e cila tashmë qëndron në themelet e shkollës shqiptare të përkthimit dhe që quhet shqipërim, rikrijim. Kjo metodë i lejon përdorimin e gjuhës popullore dhe liri veprimi mbi tekstin. (Plasari, 201-202)

Noli e kishte lexuar librin në spanjisht, pasi e njihte gjuhën e Cervantes-it, kjo ia mundësoi përkthimin nga gjuha e autorit, pra u solli shqiptarëve një përkthim nga teksti origjinal dhe konsultoi botime në gjuhë të tjera para se të ndërmarrë botimin e *Don Kishotit*. Noli, kishte lexuar një literaturë të gjerë studimore në gjuhë të ndryshme mbi librin *Don Kishoti* dhe autorin, gjithashtu pati sintetizuar qëndrimin e tij kritik ndaj veprës dhe personazheve, kur ende ishte në proces përkthimi, gjë që e shprehu në artikuj të ndryshëm gazetareskë. Mendojmë se këto janë arsyt kryesore pse përkthimi i tij i qëndron kohës.

“Noli si shqipëruar, dallohet për një kuptim mjaft të mirë të tekstit origjinal. Nga një ballafaqim i origjinalit me shqipërimin, dallohet sa ai ka përdorur për këshillim dhe përkthime në gjuhë të tjera si: italisht, anglisht, frëngjisht. Siguria në të kuptuarit e tekstit bie në sy edhe në ato vise të veprës për të cilat përkthimet e tjera kanë luhate.” (Plasari 202)

Gjuha e Nolit në përkthim është e fuqishme dhe ekspresive. Përkthimi shkëlqeu, jo vetëm për arsye të talentit të përkthyesit, por dhe të njohjes me themel të disa gjuhëve, të njohjes së kulturës e historisë botërore, e spanjolle. Ky përkthim ishte cilësor edhe sepse Noli ishte një njohës shumë i mire i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqipe. Këtë e vërtetojnë dhe disa artikuj të botuar nga ai vetë në Gazetën *Republika*, si dhe Introdakta që i ka bërë librit.

R. S. Lizaralde, përkthyes e shkrimtar spanjoll, njohës i mirë i gjuhës e letërsisë shqipe, mendon se shkurtimet që Noli i bëri veprës:

“...mund të konsideroheshin si një krim i vërtetë përkthimor, nuk ia heqin as vlerën më të vogël punës së tij të guximshme: pasuria semantike që shpalos, gjithmonë në gjuhë popullore, aftësia për të riprodhuar deri ngjyrimet satirike shumë të holla qoftë dhe në shprehje, toponime apo emra njerëzish, gjallëria e gjuhës, përdorimi i arkaizmave orientale për të riprodhuar efektin parodik të arkaizmave servantine të romanit kalorësiak, e gjitha kjo (shto të tjera) e shndërron versionin e Fan S. Nolit në një kryevepër të vërtetë në gjuhën shqipe, si për nga stili i mrekullueshëm dhe magjepsës ashtu dhe për nga forca dhe aftësia e tij për të depërtuar (njëlloj si Kishoti origjinal) në të gjitha shtresat e popullsisë. sojliu dhe shqyrtari i tij u shndërruan në personazhe plotësisht të integruar në imagjinatën dhe mendësinë e shqiptarëve të asaj kohe dhe të atyre të mëvonshme.” (Lizaralde 46)

Mendojmë se Noli realizoi shkurtimet përgjatë rrugëtimit të përkthimit, pasi ai pati parashikuar ta nxirrte librin me gjashtë vëllime por e nxori me pesë. Prologun dhe poezitë janë shkurtimet më të rëndësishme, por jo të vetmet. Akti i shkurtimit në vetvete është një kontribut që përkthimi të konsiderohet shqipërim rikrijues.

Ky përkthim me të drejtë është quajtur rikrijues, pasi përkthyesi i ka lejuar vetes të ndërhyjë e të operojë në tekst lirshëm, ka shmangur shumë elementë kulturorë të tekstit origjinal, si rrjedhim procesi i përkthimit është shoqëruar me humbje të pakthyeshme.

2. Sojliu mendje- mprehtë Don Kishoti i Mançës në gazetën Republika

Nolit u bë zëri i parë kritik serioz mbi veprën *Don Kishoti i Mançës* në Shqipëri, me parathënien të cilën e quajti Introdiktë, ku zbuloi shtysat për të sjellë *Kishotin* për shqiptarët. Emancipimi kulturor i lexuesit shqiptar ka rëndësi parësore për Nolin. Kjo është arsyeja pse ai i sjell lexuesit në shqip një “kryevepër letrare”, “një dhuratë të lezeçme”, “veprën më të lezeçme të botës”, “një nga veprat më popullore të botës”, “libër që pati një sukses aq të madh”, etj. (Noli, Introdikta 5)

Introdikta është një vijim logjik i disa artikujve që Fan Noli dhe të tjerë personazhe publike kanë botuar në gazetën Republika, ndërkohë që libri përkthehej dhe botohej në po këtë gazetë. Lexuesi shqiptar i fillim shekullit të XX ishte i pakët në numër, duke iu referuar të dhënave të kohës, pasi analfabetizmi arrinte 93% të popullsisë, por artikullshkruesit përgatisnin terrenin për lexuesin duke sjellë informacion mbi veprën ndërkombëtarisht të përkthyer, rëndësinë kulturore dhe emancipuese të saj, filozofinë që ajo mbart, heroin kryesor dhe autorin.

“Don Kihoti, kalorësi trim – jo i arratisur- i Mançës është i dehur me një ideal- jo ideal të vdekur por të gjallë. Për këtë ideal Don Kihoti është gati të përballë çdo mundim dhe çdo hidhërim, të japë shpirtin e tij. Don Kihoti rron jashtë vetes tij, rron për të tjerët rron për botën, rron të shkëlqejë shejtanlleket e njerëzve me gjithë rrënjë, të lëftojë forcat e padrejtësisë. Për veten e tij as mejtohet fare.” (Studenti 2)

Artikullshkruesi, Studenti, ndërsa sjell figurën e Kishotit, replikon me Fan Nolin dhe analizën që ky i fundit i dedikon Kishotit si personazh, në një artikull të tij botuar në gazetën Republika të datës 1 tetor 1931. Studenti, në analizën e tij mbështetet në një studim të shkrimtarit të përmendur rus Turgenievit, ai mendonte se Noli, keq interpretonte personazhin, kuptimin e tij. Ky debat u shoqërua nga të tjerë, në periodikët e kohës të cilët botoheshin jashtë Shqipërisë, ndërsa vepra ende nuk ishte botuar si libër i plotë, ndërsa përkthyesi botonte në Gazetë Republika, të Bostonit në gjuhën shqipe, pjesë – pjesë përkthimin e tij.

Kishoti, ra pre e debateve që në prezantimin e tij, u bë i njohur ende pa u lexuar shqip sipas interpretimeve, u debatua për të sikur të ishte një hero me mish e kocka, një hero real.

Artikujt e fillimit të viteve 30 në gazetën Republika të Bostonit, na dëshmojnë se Noli, përkthyesi i romanit është njëherësh studiuesi i parë i veprës së Cervantesit. Ai hodhi bazat e receptimit të kësaj vepre edhe në Introdiktën që shoqëroi botimin e romanit duke krijuar kështu një horizont pritës të veprës në Shqipëri. Fan Noli nxiti lexuesin shqiptar drejt leximit të librit me këto fjalë: “Don Kishoti i Mançës ka qenë, për çdo komb e për çdo vend, një nga veprat më popullore të botës, popullore dhe për çilimijtë, dhe për filozofët e vrenjtur, si Kanti, Shopenhaueri, Eduard Fitzgeraldi, përkthyesi i dëgjuar i Omar Khajanit, e quan si veprën më të lezeçme të botë.” (Noli Introdikta 5- 6)

Duket se Noli kishte pritshmërinë e përligjur që vepra nga më populloret në botë të bëhej tejet popullore për shqiptarët, dhe ju kërkon shqiptarëve të mos e quajnë të huaj, në prezantimin e parë që i bëri *Don Kishotit*, u kërkon ta marrin për të tyrin: “E kemi njëkombas, arnaut të kulluar...” (5) Sipas Nolit në Shqipëri ka me mijëra Don Kishotër.

Fan Stilian Noli, në vitin 1931, ndërsa ishte përfshirë në procesin e përkthimit të librit dhe botimit në gazetën *Republika*, në Boston të SH B A, shkruan artikullin, *Për Don Kihotin*. (Noli, Don Kihotin 1) Noli shpërfaq vizioni e tij për personazhin, para lexuesve të pritshëm, dhe inkurajon leximin e romanit mbështetur mbi filozofinë e tij:

Së pari, ai vlerëson vlerat artistike të veprës: “*Ka nja njëzet a tridhjetë kryevepra letrare të cilat s’duhet të vdesë njeriu para se t’i këndonjë. Një prej këtyre është “Don Kihoti” i shkrimtarit spanjoll Miguel de Cervantes Saavedra. Kemi nisur t’a botojmë në “Republikën” që prej dy javësh. Është dhurata më e lezeçme që mund t’ju bëjmë këndonjës të dashur. Jemi shigur që do ta shijoni. Është e pamundur të mos ju pëlqejë. Këndonjeni me vërejtjen që meriton.*” (1)

Së dyti, Noli u flet lexuesve për karakterin komik dhe tragjik të librit pasi ai shkruan: “*Të vjen të qash e të qeshësh me ato që thot’ me ato që bën... Kështu kanë qeshur e kanë qarë, dyke kënduar Don Kishotin, me miliona njerëz qindra vjete me radhë.*” (1)

Së treti, Noli zbulon karakterin gjithëkohor dhe universal të veprës: “*Se Don Kishoti është një tip i pavdekshëm. Hidhni syrin ku të doni e do t’a shihni të gjallë përpara jush në çdo çip e në çdo çap.*” (1)

Së katërti, Noli e vlerëson gjuhën shqipe si mjaft të përshtatshme në përkthimin e Kishotit, madje ai i premton lexuesit një *Kishot* pranë traditës shqiptare, por që ta lexojnë duhet të paguajnë abonimin në gazetë: “Mos u- kurseni, po na dërgoni pajtimet. Jua kërkojmë jo vetëm ne por por jua kërkon dhe i dëgjuari kalorës i arratisur, Don Kihoti i Mançës, që po jua paraqitim me takie e me fustanellë. Ju bëftë mirë!” (1)

Së pesti, Noli zbulon pikëpamjen që ai ka për Shqipërinë duke e lidhur me Kishotin si simbol i prapambetjes, naivitetit, komicitetit, i cili ka shëmbëlltyrat e tij në Shqipëri: “Në Shqipëri kemi me mijëra Don Kihotër, reaksionarë të padjallëzuar, që përpigën t’a kthejnë rrotën e historisë prapa, njerëz që rrojnë me prrallat dhe fandazmat e patriakalizms dhe feodalizms orientale. Këta reaksionarë janë komikë, se të bëjnë të qeshësh me prapambetjen e tyre, por janë dhe tragjikë, se sakrifikohen për ato prralla dhe për ato fantazma tamam si Don Kishoti.” (1)

Së fundmi, Noli ngre një pyetje ekzistenciale për fatet e Shqipërisë, ky është shqetësimi më i madh i Nolit dhe i klasës intelektuale që ai përfaqëson: “Don Kihoti, vdiq ashtu si rroj, si kalorës i kohës së mesme, i arratisur në kohën moderne. A do të vdesin kështu dhe Shqiptarët?” (1)

Ndërsa Noli u kërkon shqiptarëve të mos e quajnë për të huaj, në prezantimin e parë që i bëri *Don Kishotit*, u kërkon ta marrin për të tyrin: “E kemi njëkombas, arnaut.” Sipas Nolit në Shqipëri ka me mijëra Don Kishotër. Këto grupe sociale, kërkonin rikthimin e kohëve të vjetra të shoqërisë. Noli e vuri veprën në shërbim të qëllimeve politike e demokratike që aspironte e ndiqte. Interpretimi që Noli i bën figurave të romanit nuk është shterues, e as i mjaftueshëm e ndonjëherë as i saktë. Ai më fort u përpoq ta sillte në bashkëkohësi, se sa të zbulonte dykuptimësinë e shumëkuptimësinë e figurave të romanit. Sot interpretimi i Nolit duket i njëanshëm.

Në gazetën *Republika*, të Bostonit, me datë 22 tetor 1931, artikullshkruesi me pseudonimin *Studenti*, shkruan artikullin *Don Kishoti dhe Shqipëria*. Me një gjuhë shumë entuziaste, ai shpreh gëzimin që ky roman po vjen në gjuhën shqipe, si dhe paraqet vlerat e përkthyesit, domethënien e madhe që mban përkthimi i librit për Shqipërinë dhe shqiptarët. “Besojmë padyshim se ky “kalorës i pendës” që po shqipëron kryeveprën e Cervantesit, për të mirën e Shqipëtarëve të gjithë: jo vetëm për ata që duan të vdesin për Shqipërinë.” (Studenti 1)

Studenti, në vijim ndërton polemikë me Nolin, artikullshkruesin e një shkrimi mbi Kishotin, me datë 3 tetor 1931. Dy artikujt përballen në konceptet se çfarë përfaqëson figura e heroit dhe idealin që mbart ai. Studenti, qartë e kthjellët shprehet se nuk është e vërtetë që në Shqipëri kemi me qindra Don Kishotër, por:

“Shqiptarët do të ishin më të lumturit e botës po të kishin me të vërtetë kaq shumë Don Kihotër në mes tyre. ..Don Kihoti lëfton për ata që nuk lëftojnë dot për veten e tyreKa burra të tillë Shqipëria vallë? Asnjë! Po jo se një mund t’a ketë, po mijëra s’ka as Shqipëria, as ndonjë vend tjetër. Bota e tërë ka nevojë të madhe për burra si Don Kihoti....pa përpjekjet e Don Kishotërve do t’i kish ngrënë mortja njerëzit dhe qytetërinë e tyre.” (Studenti 2)

Figura e heroit të romanit të Cervantesit, ka ngritur një polemikë të rëndësishme dhe kontradiktore. Kjo polemikë nuk pushoi as në vijim pasi e mban ndezur dhe e ushqen Fan Noli, përkthyesi i veprës i cili nuk ndan të njëjtin mendim me Studentin.

Sipas analizës së Saverina Pashos, përkthyes e studiuese e letërsisë botërore :

Nuk duhet harruar që përkthimi nuk është një proces thjesht teknik, por një proces ideologjik pra edhe politik që nuk i përgjigjet vetëm kërkesave të besnikërisë ndaj tekstit burimor, por edhe kërkesave të kohës, vlerave që lidhen me horizontin pritës së veprës së përkthyer gjithashtu. Në rastin e Nolit, duhet të marrim parasysh përveç kësaj edhe vetë personalitetin e tij emblematic, faktin që ai nuk ishte vetëm përkthyes por edhe poet i pajisur me një mendim të rafinuar e të pasur, me një erudicion filologjik e religjioz, me një frymë polemizuese e me pasione të forta politike. Kështu mund ta kuptojmë më mirë pse Noli zgjodhi për të përkthyer Don Kishotin si dhe pse e pajisi me Introduktën që është kontestuar kaq fort në debatet e kohëve të fundit mbi nevojën e ripërkthimit të kësaj vepre. (Pasho 102)

Në dhjetor të vitit 1931, po në gazetën Republika, Noli shkruan në rubrikën *Andej – Këtej*, një artikull ku trajton katër çështje të cilat ai i ndeshi gjatë procesit të përkthimit dhe i vlerësoi të rëndësishme t’ia bënte të ditura publikut lexues. Secila çështje vjen si nëntitull i artikullit, nga ku kemi përzgjedhur disa. Si lexues ndërsa i japim vëmendje këtij artikulli zbulojmë dëshirën e përkthyesit për bashkëpunim me lexuesin në këtë proces *live*. Dëshirën që të mos humbasë apo mërzisë lexuesin, sepse heroi po ndryshon emër. Dëshirën e përkthyesit të argumentojnë së bashku për çështje përkthimore.

E para: *Don Kihoti apo Don Kishoti?* Noli ka vendosur të rishikojë shqiptimin në shqip të emrit të heroit të veprës, nga Kihoti në Kishoti për disa arsye: “*Kështu më shumë ia prononcojnë emrin edhe Frenqtë edhe Italianët. Vija re se më të shumtët e shqiptarëve e prononconin emrin e Kalorësit të Mançës, Don Kioti, që është një gjynah i pandjerë. Kjo më shtrëngoq t’ia transkriboj emrin ashtu si ia prononconin Spanjollët në shekullin e shtatëmbëdhjetë, domethënë Don Kishoti.*” (Noli, *Andej – Këtej* 1)

E dyta: *Tragjik apo Komik?* Noli mendon se Kishoti është: “*Tragjik subjektivisht, domethënë për veten e tij, dhe është komik objektivisht, domethënë për të jashtëmit. A mund të quhet atëhere tragjikomik? Nofta, po as kjo s’i jakështis tamam, se është çehit më vete.*” (1)

Noli është njohës i mirë i kritikës letrare bashkëkohore mbi veprën, prandaj ai ndërton tezat e tij pro dhe kundër. Për Nolin ka rëndësi të madhe shtresa sociale nga vjen heroi, për të kuptuar e shpjeguar sjelljen e tij, kështu ai nuk bie dakord me kritikën letrare botërore e cila nuk i jep rëndësi të veçantë kësaj teze. Noli i quan të lajthitura shumë kritika letrare që i janë bërë romanit, prandaj me forcë kundërshton “shkrimtarin rus Turgenjev, që e paraqet Don Kishotin si një kryetrim tragjik një radhë me Hamletin” (1) dhe të tjerë si shkrimtari francez, Anatole France i cili e paraqet si: “një palaço komik me të cilin qeshin çlimijtë.” (1)

E treta: *Ç'farë bejlurçine?* Noli argumenton se figura e Kishotit ka të njëtat karakteristika me bejlurçinën e katundit. “*Se kjo është karakteristika e bejlurçinës, që s’ka ngjyrë, s’ka bazë, s’ka karakter e s’ka moral. Se kllasi i bejlurçinës s’ka bazë e qëndron n’erë.*” (1) Noli e paraqet Kishotin si përfaqësues të një shtrese sociale pa vlera shoqërore, pa bosht, të rënë nga vakti, që është e aftë të bëjë çdo gjë për ta rimarrë parajsën e humbur.

E katërta: *Sakrifikohet për reaksionin.* Për Nolin, Kishoti nuk është idealist e as sakrifikohet për ideal. “*Admirojmë njerëz që sakrifikohen për idealet e përparimit të njerëzisë. Për ato që sakrifikohen për ideale mitologjike, si ato të Don Kishotit, qeshim, s’kemi veç se të qeshim, e diku mallëngjehemi për foshnjërinë e tyre.*” (1) Sipas tij idealet e Kishotit nuk sjellin asnjë gjë të mirë, asnjë përfitim, por i shërbejnë reaksionit që dëshiron të kthejë historinë mbrapa.

Në vitin 1932, me nëntitull *Tragjedia e Shqipërisë*, Noli nënvizon një ide të parashtruar më parë e së cilës do t’i qëndronte edhe do ta mbronte në vazhdimësi: “*...tragjedia e Shqipërisë është ajo e katundarit të varfër e të paditur që i vete pas bejlurçinës së tipit të Don Kishotit.*” Autori analizon klasat e shoqërisë shqiptarë, duke ngritur pyetjen - *nga do t’i vijë shpëtimi vendit?* (Noli, *Tragjedia* 1)

Sipas Nolit përkatësia klasore e dy personazheve është shumë e rëndësishme deri përcaktuese në sjelljen e tyre, zgjedhjet e vendimet që ata ndërmarrin. Në *Gazetën Republika*, nr 59, Noli vë re se: “*Shumica e kritikëve as e përmendin këtë gjë, ndonëse kjo është rrënjja e karakterit të Don Kishotit.*” (1) Duke ndërtuar paralelizma mes dy protagonistëve si përfaqësues të klasave të caktuara shoqërore dhe klasës së bejlurçinës e të laros në Shqipëri, Noli gjen arsyen kryesore pse kjo vepër do të pëlqehet tek ne. Interpretimi i veprës nga ana e tij, në gazetën *Republika* lidhet ngushtë me qëndrimin politik të Nolit, luftë kundër reaksionit borgjezo çifligar të viteve 30 në Shqipëri.

3. Debati për Kishotin në gazeta të tjera të kohës

Kishoti në Shqipëri erdhi ende pa u përkthyer romani *Sojliu mendje mprehtë Don Kishoti i Mançës* nga Noli. Shtypi shqiptar në Boston, në vitin 1909, i referohet figurës së Don Kishotit dhe Sanço Pançës, duke e marrë të mirëqenë se lexuesi i tij shqipfolës i njeh ata, ende pa u përkthyer libri në gjuhën shqipe. Artikulli titullohej *Don Kishoti i 1908*. Artikullshkruesi me pseudonimin Shtegu- Pelës, preokupohet jo për heronjtë e Cervantes-it, por për gjendjen e Shqipërisë nën perandorinë Osmane të Turqve të Rinj, në kushtet kur lëvizja shqiptare për pavarësi ishte në kulmet e saj. Figura e dy personazheve vjen në simbolikën e tyre, e aktualizohet në kontekstin shqiptar të kohës. Autori i përshkruan heronjtë e Cervantes-it:

Don Quichoti "harron gjendjen e tij të vërtetë dhe epet me fondasi kaqë tepër sa të luftojë me erën dhe me hijet e lisave dhe t'i duket sikur është herua i vërtetë. Don Quichot'i sotmë (Zhon Turqit dua të them) duke vajtur në përrëndim, ca me të hollat e patishahut dhe ca të rënë në gazep të tij, u dhanë si Don Quichoti në fondasi dhe deshnë t'a përsëritin Turqinë, së cilës i merreshin këmbët si kalit Don Quichoti." (Shtegu i Pelës 1)

Është mjaft interesante të lexojmë se, nuk është Noli i pari që idealizoi dy personazhet e Cervantes-it, madje ata vendosen në kontekstin shqiptar dhe mbartin portretizime aktuale për kohën që në vitin 1909. Shtegu –Pelës, trishtohet nga sjellja e shqyrtarit ndjekës të cilin e quan pasës, të bindur e të përlur, të cilin e barazon me popullsinë fshatare shqiptare që ishte dominuese në vend, e cila ruan të njëjtën përlurje në sjellje.

"Sado të çudiçime që të ishin idetë e Don Quichotit, gjeti një pasës, Sanço Pançen e përjetëshëm, Shqiptarët... Mua, si Shqipëtar, s'më hyn kaqë në punë herua i romanit, sa më hyn pasësi... Sa për Sanço Pançet mund t'a themi se në mos e mbajçin dot emrin e shtrejtë Shqipëtar, mund t'a këmbëjnë me çdo emër, po jo me emër barbar Osmanlli; dini cdo me thënë osmanlli?...Shtërgjysh i Hamidit nga Tataristani!" (Shtegu i Pelës, 1909:1)

Në vitin 1928, profesori i letërsisë nga Shkodra, njëkohësisht përkthyes dhe përshtatës veprash letrare për teatër, Ndoc Vasija, përktheu pjesë nga dy librat e Cervantesit, *Don Kishoti i Mançës*. Shtypi shqiptar i kohës i bëri jehonë përkthimit në gjuhën shqipe të librit me titull *Aventurat e Don Kishjoti të Cervantes*. Ky është prezantimi i parë i librit përpara lexuesit shqiptar, prandaj Revista Dituria, paraqet një përmbledhje të shkurtër të veprës, ku zbulimi i karaktereve të dy personazheve mban peshën kryesore. *"Është histori e një njeriu që rron me një ëndrrë, me një ideal... kurse Sançua, shërbëtori i tij, që s'thëllon nga mendja dhe kujdes tepër barkun dhe qejfin, i jep këshilla urtësie, kërkon t'a zgjojë, t'a bjerë në realitet, në të vërtetënë përdhese."* (Diturija 355)

Revista e përcjell romanin me një qasje humoristike, duke u bërë vend në këtë mënyrë personazheve të adhureshëm për nga mendimi dhe sjellja e tyre, dhe ndërsa e përgatit lexuesin të qeshë, përgjithëson shembullin e Kishotit; ai nuk është thjeshtë një tip por arketip. *"Don Kishoti është një pasqyrë: sa njerëz janë si heronj i këtij romani, të lumturë në marrëzinë e tyre shpirtmadhe, të shogruarë në një veprë të kandshme për ta, që u jep gëzim dhe kënaqësi intime shpirtit."* (Diturija 355)

Në gazetën e fillim shekullit të XX, vepra u parapri me komente entuziaste, si dhe shpjegime të qarta përse po përkthehej në shqip *Don Kishoti*. Këto komente disa here kishin veshur kontekste politike vend e pavend, por në raste të tjera përkthimi lidhet ngushtë me zhvillimin e përparimin kulturor të vendit dhe shqiptarëve, me pasurinë e gjuhës shqipe. *"Sido që të thonë miqtë dhe sido që të bëjnë armiqët, Shqipëria po përparon. Përkthimi i Don Kishotit në gjuhën shqipe, mund të themi është në mos më e madhja fare, një nga shenjat më të mëdha të këtij përparimi"*. (Studenti 1)

Revista *Diturija* e Lumo Skëndos, ishte një nga organet e rëndësishme të shtypit të kohës, e cila trajtonte çështje të letërsisë, gjuhës dhe kulturës, e cila njoftoi lexuesin për botimin e romanit në shqip. *Kishoti*, vjen në profilin e tij letrar, prezantohet si: “*një roman shkurtore e një veprë shkruar spanjisht, por e bërë botënore, e përkthyer në gjithë gjuhët e dheut, e kënduarë prej miliunë njerës, që tre shekull e tëhu.*” (Revista Diturija 355)

Në vitin 1933, Fiqiri Llagami, sjell një koment të shkurtër të librit *Don Kishoti* në Gazetën *Besa*. Nënfaqja e gazetës *Besa*, në 6 pjesë, botoi një përmbledhje të librit të shoqëruar me komente. Duket se artikullshkruesi e ka lexuar librin italisht pasi emrat e përveçëm ai i ka sjellë italisht, si: Michele Cervantes, Ronzinante, Don Kishotti, Sancio Panza, etj. (Lagami 1)

Në vitin 1934 romani i Cervantesit dhe figura e Kishotit u vunë në qendër të një debati mes intelektualëve shqiptarë në revistën “Illyria”. Tajar Zavalani dhe Vangjo Nirvana, përfaqësues të rretheve intelektuale, u përfshinë në një debat ideologjik, i cili në i cili ishte shprehje e shqetësimit qytetar për të ardhmen e Shqipërisë. Klasa intelektuale shqiptare jep shenja pjekurie ndërsa debaton: “*Në kohën tonë përpjekja e mendimeve bëhet sidomos me anën e fjalës së shtypur dhe atëhere merr formën e polemikës.*” (Zavalani 1)

Vangjo Nirvana, është emri me të cilin firmoste shkrimet e tij intelektual Vangjel Koça, i cili shkroi në një artikull: “*Ata që duan të çajnë një rrugë të re në jetën e Shqipërisë, ata që duan të krijojnë një frymë të re në botën shqiptare, janë Don Kishotër sot për sot.*” (Nirvana 1)

Ndërsa Tajar Zavalani e kundërshtoi Nirvanën, pasi Kishoti sipas tij ishte:

“*Tipi i mbaruar i kalorësit në një kohë kur roli historik e social i kalorësisë mesjetare kishte marrë fund... Përfaqëson një botë historikisht të kapërcyer, lëfton për do ideale dhe sidomos me do mjete që s’janë të kohë së tij dhe prandaj në çdo hap bëhet qesharak.*” (Zavalani 1)

“*Jo Don Kishot, po militant të frymës së re do ta quaja unë typin e Përpjekjes s’onë.*” (Zavalani 2)

Debati zhvillohet në dy drejtime, së pari Zavalani nuk quante “*donkishoteske*”, qesharake e utopike, kërkimet e inteligjencës bashkëkohore për një ideal të ri social, i cili do ta tërhiqte kombin tonë në rrugën e progresit e të qytetërimit perëndimor. Së dyti, Zavalani i përmbahej po atij vlerësimi që pati formuluar Noli për Kishotin, si simbol i forcave shoqërore reaksionare, që përpiqeshin ta kthenin prapa rrjedhën e historisë. Tajar Zavalani, shihte të shkonin në dy kahe krejtësisht të kundërt - Kishoti personazh dhe klasën intelektuale shqiptare, e cila kërkonte shkëputjen nga e shkuara, e nuk ishte e verbuar nga ëndrrat e fantazisë, nga utopia. Kjo ide zbulohet qartë që në titull: *Don Kishotë apo Pionerë*.

Polemikën është e ndezur mes dy intelektualëve shqiptarë, të cilën Nirvana e quan “*luftë ideologjike*”. (Nirvana 1) Secili dëshiron të lavdërojë përpjekjet e klasës intelektuale ideologjinë e së cilës mbështet e përfaqëson, por nuk bien dakord, nuk kanë të njëjtin kuptim mbi vlerat e personazhit Kishot, i cili nga letërsia erdhi e u mishërua si të qe një human i vërtetë. Pas këtij debati intelektual qëndrojnë padyshim bindjet politike të tyre dhe jo çka ofronte vetë teksti i romanit.

Është mjaft interesante të shikosh si vijon debati, pas botimit të librit *Don Kishoti*, gjatë viteve 30, nga dy grupimet e ndryshme politike që etiketohen Don Kishotër. Në vitin 1934, në debatin intelektual të zhvilluar në revistën “Illyria”, Tajar Zavalani dhe Vangjo Nirvana, përfaqësues të rretheve të caktuara intelektuale e politike, përcollën preokupimin për të ardhmen e Shqipërisë, të cilat nuk ishin thjesht personale. Vangjo Nirvana ndërton qartë idenë e tij në një artikull të datës 8 korrik, 1934, të gazetës *Illyria*. Sipas tij Kishoti nuk është një figurë qesharake siç pandehet përgjithësisht, po një hero i vërtetë në kuptimin e thellë të fjalës. Shpreh heroizmin e një shpirti që përpiket për një gjë të bukur e të drejtë, kundër çdo konvencioni, poshtërsie, egoizmi e vulgariteti.

BIBLIOGRAFIA

- Cervantes, Migel. *Aventurat e Don Kishjotit të Cervantes*. Shkodër: Zonja e Papërlyeme. 1928. Print.
- Kadare, Ismail. “Don Kishoti në Ballkan”. *Unaza në Kthetra*. Tiranë: Onufri. 2001. 46. Print.
- Lizaralde, Ramon Sanchez. *Shqipëria në pasqyrën e letërsisë*. Tiranë: Onufri. 2008. 46. Print.
- Llagami, Fiqiri. “Aventurat e Don Kishot-it”. Nënfileta e Gazetës Besa. 5- 10 gusht 1933: 1. Print.
- Nirvana, Vangjo. “Ana tjetër e medaljes”. *Gazeta Illyria*. Tiranë. nr. 18. 8 korrik 1934:1. Print.
- Noli, Fan. “Andej –Ketej”. *Gazeta Republika*. nr 59. Boston: Mass. 17 dhjetor 1931:1. Print.
- Noli, Fan. “Andej –Ketej. Tragjedia e Shqipërisë”. *Gazeta Republika*. nr 67. Boston: Mass. 18 shkurt 1932: 1. Print.
- Noli, Fan. “Andej- Këtej. Për Don Kihotin”. *Gazeta Republika*. nr. 48. Boston: Mass. 1 tetor 1931: 1-2. Print.
- Noli, Fan. “Introdukta”. *Don Kishoti i Mançës*. Tiranë: Onufri. 2008. Print.
- Noli, Fan. “Parathënia”. *Don Kishoti i Mançës*. Tiranë: Naim Frashëri. 1977: 5- 6. Print.
- Pasho, Saverina. “La retraduction des œuvres littéraires- nécessité ou tendance?” *Atelier de traduction*. nr. 18. Universiteti Stefan cel Mare. Suaceva. 2012: 99-109. web. 09. nëntor 2020.
- Plasari, Aurel. *Don Kishoti zbret në Shqipëri*. Tiranë: Naim Frashëri. 1990: 201- 202. Print.
- Studenti. “Don Kishoti dhe Shqipëria”. *Gazeta Republika*. Boston: Mass. 22 tetor 1931: 1- 2. Print.
- Studenti. “Don Kishoti dhe Shqipëria”. *Gazeta Republika*. Boston: Mass. 3 tetor 1931: 2. Print.
- Shtegu- Pelës. “Don Quichoti i 1908”. *Gazeta Dielli*. Boston: Mass. 23 mars 1909: 1. Print.
- Uçi, Alfred. “Si u prit Don Kishoti në Shqipëri”. *Gazeta ABC*. Tiranë. 17 dhjetor 2005: 2. Print.
- Zavalani, Tajar. “Don Kishotë apo pionierë?”. *Gazeta Illyria*. Tiranë. 24 qershor 1934: 1- 2. Print.
- Mit’hat Frashëri. *Revista Diturija*. Vol.III. Nr. 9. 10. 11. Tiranë. korrik. gusht. shtator. 1928: 355-358. Print.